



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1600/2016
Nr. fq/Br.str./Nr.pg. 21/12/16
Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS AVOKATI I POPULLIT

lidhur me
monitorimin e Qendrës së Paraburgimit në Lipjan

Për: **Znj. Dhurata Hoxha, Ministre**
Ministria e Drejtësisë

Z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm për Shëndetësi në Burgje,
Ministria e Shëndetësisë

Z. Imet Rahmani, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Sokol Zogaj, u.d. Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Arif Beqa, drejtor
Qendra e Paraburgimit në Lipjan

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit më 7 shtator dhe 19 tetor 2016 ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Prishtinë, më 21 dhjetor 2016

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

- Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejme "MKPT") i Avokatit të Popullit më 7 shtator dhe 19 tetor 2016 ka vizituuar Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Grupi monitorues përbëhej nga një këshilltarë ligjor, një psikologe dhe një mjek-kirurge.

Qendra e Paraburgimit në Lipjan

Hyrje

- Qendra e Paraburgimit në Lipjan (QPL) gjendet në kilometrin e tretë të qytetit të Lipjanit te rruga që e lidh qytetin e Lipjanit me Maguren, e cila është ngjitur me Qendrën Korrektuese të Lipjanit. Qendra e Paraburgimit në Lipjan është ndërtuar në vitin 2003 dhe në atë kohë menaxhohej nga UNMIK-u. Kjo qendër në shator të vitit 2004 është mbyllur për shkaqe teknike si pasojë e dëmtimeve teknike që ka pasur, është riparuar dhe është hapur në tetor të vitit 2006 ku vazhdon të punoj edhe me tutje nën menaxhimin e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Drejtorisë Qendrore. Në vitin 2006 kompetencat janë dorëzuar tek stafi menaxhues vendor.¹
- QPL akomodon të paraburgosurit dhe një numër të vogël të personave të dënuar të cilët janë të akomoduar në një krah të veçantë.² Gjatë vizitës më 7 shtator 2016, ekipi u njoftua nga drejtoria e QPL se në momentin e vizitës akomodoheshin 133 persona të paraburgosur dhe 8 të dënuar.
- Ndërsa, gjatë vizitës më 19 tetor 2016, MKPT u njoftua se kishte filluar transferimi i të akomoduarve në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe se deri në atë moment 40 të akomoduar ishin transferuar.

MKPT u njoftua se QPL asnjëherë nuk është vizituuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

- Gjatë vizitës së MKPT në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrrën dhe iu mundësua biseda me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

Keqtrajtimi

- Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT nuk pranoi asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe të dënuarit për keqtrajtim dhe përdorim të tepruar të forcës nga ana e zyrtarëve korrektues të kësaj qendre. Po ashtu, ekipi monitorues gjatë vizitës nuk ka pranuar asnjë ankesë për dhunë ndërmjet personave të akomoduar në këtë qendër, si në pjesën ku akomodohen të paraburgosurit, ashtu edhe në pjesën ku mbahen të dënuarit.

¹ Ueb faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, në: <http://www.md-ks.net/?page=1,72#?page> (8.09.2016).

² Personat e dënuar janë të vendosur në krahun "A" të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan.

Kushtet materiale

7. MKPT ka vërejtur se kushtet ku mbaheshin të dënuarit ishin më të mira se në pjesën ku mbaheshin të paraburgosurit. Gjatë vizitës në krahun ku mbaheshin të dënuarit, MKPT ka vërejtur se në qeli akomodoheshin nga 1 dhe maksimumi 2 persona. **MKPT, gjatë inspektimit nuk ka vërejtur mbipopullim.**
8. Qelitë posedojnë TV (nuk janë pronë e QPL) dhe dollap për ruajtje të rrobave të tyre. MKPT u njoftua nga të dënuarit se çarçafët për shtretërit e tyre u sillen nga shtëpitë e tyre dhe se nuk u jepen nga QPL. Të dënuarit mund të bënin dush sa herë që ata dëshironin, kurse banjat dhe tualetet e tyre në përgjithësi ishin në gjendje të mirë. **Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se në qelitë në krahun ku mbahen të dënuarit nuk ka lagështi.³**
9. MKPT ka vërejtur se në pjesët e QPL ku mbaheshin të paraburgosurit, në disa qeli kishte pikuar uji dhe ato duhet të gëlqerosen. Ekipi monitorues gjatë vizitës në QPL nuk ka hasur në qeli të mbipopulluara dhe në to ishin të vendosur në maksimum 3 persona. Ndërsa, tualetet dhe banjat ishin në gjendje të mirë. MKPT u njoftua nga drejtoria e QPL se planifikohet mbyllja e kësaj qendre dhe akomodimi i të paraburgosurve në objektin e ri në Hajvali. **Lidhur me njoftimin se kjo qendër do të mbylljet, MKPT do të monitorojë situatën dhe do të kërkojë informata e përditësuara nga autoritetet kompetente.**

Ushqimi

10. Të akomoduarve ushqimi u shpërndahej nëpër qelitë e tyre. Kuzhina ku përgatitet ushqimi për të akomoduarit në QPL dhe për personelinë së pjeri. MKPT u nda e kënaqur me depot ku mbahen ushqimet, nuk ka hasur në ushqime me afat të skaduar dhe mish të pavulosur. Gjithashtu, MKPT ka vërejtur që menjë ushqyese eshtë pasuruar me perime dhe bukë të zezë. **MKPT rekomandon që pakot dietale të jenë më të pasura për personat me sëmundje të ndryshme.**
11. Të angazhuarit në punë në kuzhinë ishin të pajisur me libreza adekuate sanitare. **Megjithatë, MKPT rekomandon që të angazhuarit në kuzhinë të bëjnë më shumë kujdes duke përdorur dorëzat gjatë përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit dhe rekomandon që në rastin e kryerjes së analizave nga institucioni kompetent të bëhen analizat e kompletuara, përfshirë këtu edhe strishën e duarve.**

Regjimi

12. Në QPL të paraburgosurit mund të punojnë vetëm nëse për këtë u jepet leja e gjykatës kompetente. Atyre u ofrohet shëtitje 1 orë para dite dhe 1 orë pas dite gjatë stinës së verës, ndërsa gjatë stinës së dimrit ky orar reduktohet në 45 minuta. Të paraburgosurit dhe të dënuarit gjatë kësaj periudhe mund të merren me sport siç eshtë basketbolli, futbolli dhe vrapiimi, kurse salla e fitnesit aktivizohet vetëm gjatë stinës së dimrit. **Megjithatë, QPL nuk eshtë në gjendje të ofrojë kurse dhe trajnime as për të**

³ Gjatë vizitës në QPL, MKPT u njoftua se kjo qendër do të mbylljet dhe se të akomoduarit këtu dhe personeli do të shpërngulen në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali (Prishtinë). Kjo Qendër e Paraburgimit deri më tanë nuk ka filluar punën.

dënuarit dhe as për të paraburgosurit. MKPT inkurajon autoritet kompetente të rrisin aktivitetet jashtë qelisë në QPL për të paraburgosurit. MKPT konsideron se sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes në paraburgim, po aq duhet të jetë i zhvilluar edhe regjimi i cili u ofrohet.

Kujdesi shëndetësorë

13. Përgjegjësia për kujdesin shëndetësorë në Shërbimin Korrektues u transferua nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë në korrik të vitit 2013. Gjatë vizitës, MKPT konstatoi se pati pak përmirësimë sa i përket kushteve infrastrukturore të personelit mjekësor krahasuar me vizitën e mëparshme. Personeli mjekësor druan se me ardhjen e vjeshtës dhe dimrit, në zyrat e tyre sërisht do të pikojë ujë dhe kushtet e tyre të punës do të përkeqësohen. **MKPT ka konstatuar se hapësirat ku ofrohen shërbimet mjekësore nuk janë të përshtatshme dhe janë të vogla.**
14. Personeli mjekësorë shprehu shqetësimin lidhur me vonesat e përgjigjeve nga gjykatat në rastet e rekomandimeve të dërguara dhe kërkesave për leje të gjykatës për dërgim të paraburgosurve apo dënuarve për shërim jashtë QPL. Ekipi i MKPT u njoftua se kjo çështje rregullohet mbi bazën e kategorizimit të urgjencave për trajtim. Kategoria “A” përfshin të paraburgosurit gjendja e të cilëve kërkon dërgim urgjent në institucionin tjetër shëndetësor dhe për këtë nuk pritet leja e gjykatës, por gjykata njoftohet me shkrim lidhur me rastin. Kategoria “B” nënkupton të paraburgosurit të cilët duhet të marrin trajtim shëndetësorë jashtë QPL brenda afatit prej 24 orësh. Për këtë kategori kërcohët leja e gjykatës dhe personeli mjekësor ka shprehur shqetësimin lidhur me vonesat në përgjigjet e gjykatave dhe mospërfilljen e rekomandimeve të mjekut.
15. Në kategorinë “C” përfshihen të paraburgosurit të cilët duhet të marrin shërbimin mjekësor brenda javës dhe për këtë kërcohët leja nga gjykata kompetente. Në kategorinë “D” përfshihen të paraburgosurit të cilët duhet të marrin shërbimin mjekësor të caktuar brenda muajit dhe po ashtu nevojitet leja e gjykatës. Sipas personelit mjekësorë, problematike paraqitet obligimi për ta kthyer të paraburgosurin në QPL në rast se klinika ku është dërguar më herët nuk mund t'i ofrojë shërbim dhe ai duhet të dërgohet në një klinikë tjetër. Për një transferim të tillë nevojitet sërisht leja e gjykatës.
16. Personeli mjekësor dhe drejtoria shprehën shqetësimin për faktin se në QPL akomodohen edhe të paraburgosur me probleme mentale për shkak të mungesës së hapësirës për akomodim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike apo ndonjë vend tjetër adekuat. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se për momentin në QPL akomodoheshin 2 të paraburgosur me probleme mendore, ndërsa 7 ishin duke u trajtuar në repartin e psikiatrisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).
MKPT e Avokatit të Popullit rekomandon autoritetet relevante që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për vendosjen e këtyre personave në institucionë të veçanta në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve të miratuara nga Këshilli i Evropës⁴ dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁴ *Rregullat Evropiane të Burgjeve, rregulla 12.1* “Personat të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore dhe gjendja mendore e të cilëve nuk është e përshtatshme me mbajtjen në burg duhet të vendosen në një institucion të

Përbërja e personelit mjekësor

17. Personeli mjekësorë përbëhet nga dy mjekë të përgjithshëm të angazhuar me orar të plotë dhe janë në thirrje 24 orë për rast nevoje, një psikiatër konsulantë i cili vjen në QPL një herë në javë, një psikolog me orar të plotë të punës dhe 6 infermierë. Stomatologu është i rregullt dhe ofron shërbime për të dy qendrat korrektuese në Lipjan (QKL& QPL). **Mjekët shprehën pakënaqësinë lidhur me pagesat që u bëhen për punë jashtë orarit të punës.**

Rast i grevës së urisë nga një i paraburgosur

18. Gjatë vizitës më 7 shtator 2016, në QPL, ekipi i MKPT u njoftua se i paraburgosuri B.TH ishte futur në grevë urie si shenjë pakënaqësie me vendimin e gjykatës kompetente për t'ia vazhduar masën e paraburgimit deri më 1 tetor 2016. MKPT u njoftua nga personeli mjekësor për veprimet që ndërmerrreshin për t'i ofruar të paraburgosurit kujdesin e duhur mjekësor. **Nga dokumentet e prezantuara nga personeli mjekësor dhe pohimet e të paraburgosurit në grevë ekipi i MKPT konstatoi se të paraburgosurit në grevë i ofrohej shërbimi adekuat mjekësor.**
19. Personeli mjekësor gjatë çdo vizite e kishte njoftuar të paraburgosurin për gjendjen e tij shëndetësore dhe pasojat eventuale. MKPT konstatoi se personeli mjekësor ndërmerrte veprime lidhur me të paraburgosurin në grevë, në pajtim me Deklaratën e Maltës për Grevën e Urisë.⁵ **MKPT do të vazhdojë të monitorojë këtë rast përmes vizitave dhe kontakteve me drejtorinë e QPL.**

Kontrolli mjekësorë

20. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrolllet mjekësore sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo-pranuar, jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpermjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.
21. QPL njoftoi ekipin e MKPT se të sapo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në QPL. Këto kontolle nënkuptojnë një kontrollë të përgjithshëm gjatë së cilës i paraburgosuri pytet nëse ka ndonjë sëmundje, e cila, nëse deklarohet, regjistrohet në dosjen e tij mjekësore. Por, QPL dhe qendrat tjera ku mbahen të paraburgosurit dhe të dënuarit, ende nuk ka mundësi të bëjë kontrolla sistematike për tuberkulozë, hepatit dhe AIDS. **MKPT rekomandon që autoritet relevant të ndërmarrin hapa serioz për të mundësuar kontolle të tillë**

paraparë për këtë qëllim”, në: http://www.coe.int/t/dgi/criminallawcoop/Presentation/Documents/European-Prison-Rules_978-92-871-5982-3.pdf (9.09.2016).

⁵ Miratuar nga Kuvendi i 43 i World Medical Assembly, St. Julians, Maltë, nëntor 1991 dhe i cili u rishikua nga Kuvendi i 44 i World Medical Assembly, Marbella, Spanjë, shtator 1992 dhe u rishikua nga Kuvendi i 57 i WMA General Assembly, Pilanesberg, Afrika e Jugut, në tetor 2006, në:
<http://www.wma.net/en/30publications/10policies/h31/> (9.09.2016).

sistematike në mënyrë që të detektohen me kohë sëmundjet e tillë dhe që të sapo pranuarve t'u bëhen kontolle gjithëpërfshirëse mjekësore.⁶

22. MKPT ka vërejtur se shërbimi mjekësor mban registrat si në vijim: Regjistër për tentim vetëvrasje, lëndime trupore, grevë të urisë, abuzim seksual, vdekje në burg, observimet, vetëlëndimet, si dhe protokollet e brendshme mjekësore, siç janë: protokolli i psikiatrit dhe i psikologut. Po ashtu, shërbimi mjekësor posedon edhe formularin që titullohet “**Praktika standarde e veprimeve në grevat e urisë**”, në të cilën evidentoheshin të dhënat lidhur me gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit apo të dënuarit në grevë.
23. MKPT ka vërejtur se personeli mjekësor mban evidencë të kënaqshme lidhur me kontrolllet mjekësore të kryera dhe mban evidencë me përshkime të duhura në raste të lëndimeve trupore apo vetë-lëndimeve.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

24. MKPT është interesuar nëse personeli mjekësor, të paraburgosurve dhe të dënuarve në QPL u ofron shërbimet mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrekta. Gjatë bisedës me personelin mjekësor mund të kuptohej se në raste të caktuara zyrtarët korrektaues vëzhgojnë përmes një dritareje të vogël përderisa ofrohet shërbimi mjekësor, por nuk qëndrojnë brenda. Megjithatë, mjeku kryesor ishte i vendosur se shërbimet mjekësore nuk duhet të jepen në prezencë të zyrtarëve korrektaues sepse në këtë mënyrë minohet raporti pacient-mjek. **MKPT inkurajon një qëndrim dhe praktikë të tillë të mos prezencës së zyrtarëve të sigurisë gjatë dhënieve së shërbimeve mjekësore.**⁷

Çështje të tjera

Personeli i QPL

25. Personeli i QPL përbëhet nga 130 persona të uniformuar dhe 18 nga personeli civil. MKPT u njoftu se tanë në këtë qendër janë të punësuar 3 zyrtarë social. **Gjatë vizitës, disa zyrtarë korrektaues shprehen pakënaqësítë e tyre lidhur me kushtet e punës në përgjithësi.**

Masat disiplinore

26. Sipas legjislacionit në fuqi dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia.⁸ Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondecës, përvëç kontaktave me avokatin mbrojtës, Avokatin e Popullit dhe misionet diplomatike. **MKPT konstatoi se QPL mban regjistër për masat e shqiptaura disiplinore ku shënohen të dhëna lidhur masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe mbarimit.**

⁶ Një veprim i tillë ishte rekomanduar nga Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës në raportet për Kosovën gjatë vizitave të mëparshme në institucionet e tillë në Kosovë.

⁷ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për Kosovën pas vizitës në Kosovë në vitin 2015, pati vërejtje lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore në prezencë të zyrtarëve korrektaues dhe rekmandoii ndërprerjen e praktikave të tillë.

⁸ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

27. MKPT u njoftua nga drejtoria e QPL se vetëlëndimi në këtë qendër nuk konsiderohet shkelje disiplinore. **MKPT përshëndet një qëndrim të tillë pasi që vetëlëndimi nuk përfshihet në grupin e shkelje disiplinore të parapara në nenin 102 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale**⁹
28. MKPT u njoftua se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të dënuarit për të përballuar masën disiplinore të vëtmisë. MKPT konsideron se personeli mjekësorë e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt. Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo dënuar, do të minonte raportin mjek-pacient, përvëç nëse kjo masë ndërmerrret për arsyen e mjekësore.¹⁰
29. Po ashtu, drejtoria e QPL ka shprehur shqetësimin se nuk kanë kushte adekuate për personat që vendosen në vetmi sa i përket parandalimit të vetëlëndimit.

Kontakti me botën e jashtme

30. Neni 200 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “brenda kufijve të rregullave të Qendrës së Paraburgimit” me leje të gjykatësit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, sipas këtij ligji përcaktohet se korrespondenca dhe kontaktet tjera po ashtu i nënshtrohen vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake.
31. Legjislacioni në fuqi¹¹, në rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespodencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara) kanë të drejtë për një vizitë në muaj e cila zgjatë minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. MKPT nuk ka pranuar ankesa lidhur me këtë çështje.

Procedurat e pranimit

32. Në QPL, të sapo pranuarit u nënshtrohen procedurave të pranimit e cila zgjatë nga 7 deri në 28 ditë. Gjatë kësaj periudhe ata vlerësohen dhe kategorizohen në qeli të veçuara para se të akomodohen nëpër qeli të zakonshme.
33. MKPT ka vërejtur se QPL mban dosje me informata të plota për secilin të paraburgosur apo të dënuar të cilat përvëç në dosje evidentoohen edhe në një sistem kompjuterik (baza e të dhënave).

Procedura e parashtrimit të ankesave

34. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe qendra të paraburgimit. Personat e akomoduar në këto qendra duhet të

⁹ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015 thekson shqetësimin përfaktin se në disa qendra korrektuese në Kosovë vetëlëndimi konsiderohet shkelje disiplinore.

¹⁰ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpriet praktika e kërkesës nga mjeku që të vërtetojnë se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën.

¹¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

35. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtore të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjeter, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministri i Drejtësisë.¹²
36. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të të akomoduarve në QPL janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
37. QPL mban një regjistër të plotë të kërkesave dhe ankesave të të dënuarve dhe të të paraburgosurve. **MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo vonesa për të shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor.**

Bazuar në të gjeturat e lartpërmendura gjatë inspektimit, MKPT i Avokatit të Popullit rekomandon si në vijim:


Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës

- **të bëjnë përpjekje që të dënuarve dhe të paraburgosurve t'u ofrohen kurse, trajnime dhe aktivitete jashtë qelive të tyre.**
- **të ndërmerren hapat e nevojshëm për akomodim të personave me probleme mentale në institucion të veçantë në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve të miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.**
- **MKPT i Avokatit të Popullit të njoftohet me procesin e mbylljes së Qendrës së Paraburgimit në Lipjan dhe transferimin e të akomoduarve në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.**
- **të ndërmarrin hapa serioz për të mundësuar kontolle sistematike të personave të akomoduar në mënyrë që të detektohen me kohë sëmundjet siç janë: tuberkulozi, hepatiti, AIDS.**
- **të krijojnë kushte adekuate për punë për personelin mjekësor dhe atë korrektues**

¹² Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankinin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankinin me shkrim do të jetet përgjigja në formën me shkrim.

Ministrinë e Shëndetësisë

- të ndërmarrin hapa serioz për të mundësuar kontolle sistematike të personave të akomoduar në mënyrë që të detektohen me kohë sëmundjet siç janë: tuberkulozi, hepatiti, AIDS.
- të krijojnë kushte adekuate për punë për personelin mjekësor dhe atë korrektues.

Me nederime,

Hilmi Jashari

Avokati i Popullit